



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
 AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT / AGENCIJA PROTIV KORUPCIE / ANTI-CORRUPTION AGENCY

Dep. 0.P.
 Nr. Prot. 01/3847/11
 B: Prot.
 Prot No.
 Data 04.10.2011
 Nr. I faq.
 Broj stranica
 Nr. pages

Republika e Kosovës
 Republika Kosova - Republic of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
 KOMUNA E OBILIQIT / OPŠTINA OBILIC
 DREJTORIA E ADMINISTRATIVES PËRGJITHSHME / UPRAVA OPŠTINE ADMINISTRACIJE

04.10.2011

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
 AGENCIJA PROTIV KORUPCIE
 ANTI - CORRUPTION AGENCY

Mj. organizetive	Nr. Br.	Shtetçë: Prillog:	Vlera: Vrednost:
Prillogdhenca I	XIII / 16	1851	2011

DATE/A:	04.10.2011
REFERENC-Ë:	AKK-DP
PËR/ZA/TO:	z. Altin Preniqi Menagjer i Zyrës së Prokurimit Komuna e Obiliqit.
CC:	z. Mehmet Krasniqi Kryetari Komunës së Obiliqit.
NGA/OD/FROM:	z. Hasan Preteni, Drejtore i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me tenderin "Sanimi rrugës Palaj Sibovc"



I nderuar, z. Preniqi

Duke u bazuar në nenin 19 pika 1.16 të Ligjit Nr. 04/L-051 Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik lidhur me tenderin "Sanimi i rrugës Palaj Sibovc", me nr. prokurimi: 614-11-065- 521 në Komunën e Obiliqit, sjell këtë:

OPINION

Që ju si AK t'i ndërmerreni të gjitha veprimet e nevojshme drejt evitimit të shkeljeve të lartëcekura në mënyre që të respektohen dispozitat perkatese te Ligjit nr. 03/L-241 te Prokurimit Publik të Kosovës.

Arsyetim

Para fillimit te ushtrimit te çfardo aktiviteti të prokurimit, zyrtaret e autorizuar te komunes se Obiliqit, si autoritet kontraktues, do të përgadisnin dhe nënshkruajnë Deklaraten e nevojave dhe Vendosshmërisë për Disponueshmërinë e Fondeve në përputhje me nenin 9 te Ligjit nr. 03/L-241 te Prokurimit Publik.

Nëse tenderi në fjalë është përfshirë në Planifikimin e Prokurimit atëher deklarata si dokumentë duhet të ruhet detyrimisht në dosje të tenderit. Në te kunderten duhet të përgadisë këtë Deklaratë për ta dorëzuar në Agjensionin e Prokurimit Publik në afatin prej 5 ditësh, para se zyrtari autorizues i këtij autoriteti kontraktues të autorizoi zyrtarin e prokurimit për iniciimin e aktivitetit të prokurimit me çka, sipas AKK- së, ky autoritet kontraktues ka deshtuar se respektuari dispoziten e mesiperme të nenit 9.

Zyra e prokurimit e këtij autoriteti kontraktues në Dosjen e tenderit "Punë" të procedurës së hapur me nr. të prokurimit 614- 11 - 065- 521 "Sanimi rrugës Palaj Sibovc " në Pjesën, Seksioni II, Fleta të dhënave të tenderit te kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare neni 8.1 I dosjes së tenderit të pika b, A.K ka kërkuar që ky operator të sjellë Referenca - së paku dy në vlerë mbi 100,000.00 € gjë që kjo është në kundërshtim me nenin 69 pika 6.2 LPP - së 03 / L-241.

E njëjta zyre, gjatë të njëjtes procedure ka vepruar edhe në kundërshtim me dispozitat e nenit 7 LPP- së 03/L-241, i cili obligon kete oprator ekonomik të trajtoj operatoret ekonomik në mënyr të barabart dhe jodiskriminues dhe të veprojnë në mënyr transparente.

Me respekt.